**LIGJ**
**Nr. 16/2019**

# PËR RATIFIKIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN "SIGURIA E DIGAVE", TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9965, DATË 24.7.2008

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet letërmarrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin "Siguria e digave", të ratifikuar me ligjin nr. 9965, datë 24.7.2008, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.3.2019

**Shpallur me dekretin nr. 11150, datë 25.3.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**

BANKA BOTËRORE

IBRD-IDA/GRUPI
BANKA BOTËRORE

LINDA VAN GELDER
Drejtori Rajonal, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

SH. SË TIJ, Arben Ahmetaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
SHQIPËRI

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE

Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

15 qershor, 2018

**I nderuar z. Ministër,**

*Shqipëria: Komuniteti i Energjisë së Programit të Evropës Juglindore - Projekti i Sigurisë së Digave*
*(Huaja nr. 4480 - ALB)*
*(Ripërcaktimi dhe shtyrja e datës së mbylljes)*

Ne i referohemi: a) Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Marrësi") dhe Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit ("Shoqata") ("Marrëveshja e Financimit"); dhe b) Marrëveshja e Projektit ndërmjet Shoqatës dhe Korporatës Energjetike Shqiptare ("KESH") ("Marrëveshja e Projektit"), të dyja të datës 2 korrik 2018 dhe të ndryshuara që sot për Projektin e lartpërmendur.

Marrëveshja Financiare është modifikuar si më poshtë:

1. Plani 2, seksioni IV. A2 (Tërheqja e shumës së financimit).

Tabela sipas këtij seksioni është modifikuar për të rialokuar shumat brenda kategorive ekzistuese siç pasqyrohet në shtojcën e kësaj shkrese.

2. Seksioni IV.B.2: Data e mbylljes është shtyrë deri më 31 dhjetor 2020.

I juaji shumë sinqerisht,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Linda Van Gelder
Drejtori Rajonal, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

Tel.: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701

SH. SË TIJ. Arben Ahmetaj 15 qershor, 2018

SHTOJCA
TËRHEQJA E SHUMËS SË KREDISË

| Kategoria | Shuma e kredisë së përcaktuar (shprehur në SDR) | Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen |
|---|---|---|
| 1. Mallrat dhe punimet | 14,550,000 | 100% |
| 2. Shërbimet e konsulentëve dhe trajnime përveç pjesëve 2.1 dhe 2.4 të Projektit | 5,000,000 | 100% |
| 3. Shërbimet e konsulentëve të zhvillimit të hidrocentraleve dhe menaxhimit të ujit për pjesët 2.1 dhe 2.4 të Projektit | 2,150,000 | 100% |
| **SHUMA TOTALE** | **21,700,000** | |

Tel.: +43 (1) 2170 782
Faks: +43 (1) 2170 701